REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 47,48/23
Datë/Datum. 31.01.2023
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI IEKSPERTIT SHQYRTUES

Emri dhe Mbiemri i eks. Shqyrtues dhe nënshkrimi	*Data e autorizimit të ekspertit*	*Data e dorëzimit të raportit*	Nr. i lëndës:
Burim ZEKAJ	*23.01.2023*	31.01.2023	47-48/23

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 20.01.2023, OE **"PROFITECH Shpk"** - Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 47/23, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë **OE "MONT ELEKTRO Shpk"**- Prishtine, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Furnizimi me pjesë për MRRK në TCA" : LOT.1**: Signalizator të hirit në hinka, Valva elektromagnetike, Signalizator për gelqere, termoelement, poqa sinjalizuese dhe elemente matëse" me nr. të prokurimit: **KEK-22-2966-1-1-1**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a.**

Me datën: 20.01.2023, OE **"MONT ELEKTRO Shpk"** - Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 48/23, kundër njoftimit për anulimin e procedures se prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizimi me pjesë për MRRK në TCA – **LOT. 3** - Rregullator te temperatures, Termometra bymetal,Rregullator i presionit dhe shkarkues i kondenzatit , Senzor i shtypjes 0-1 bar, dhe Kutia furnizuese me actuator per furnizim te Valvave" me nr. të prokurimit: **KEK-22-2966-1-1-1**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a.**

.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: Lot.1: 51.400,00 € (me TVSH): Lot.3: 54.500,00 € (me TVSH) €.

<u>Procedurat e zhvilluara deri ne ankesë te dorëzuar nga OE janë:</u>

Njoftimi për kontrate dhe dosja e tenderit.....06.04.2022
Procesverbali i hapjes se ofertave.....17.05.2022
Njoftimi mbi vendimin e AK-se.....30.12.2022
Kërkesa për rishqyrtim PROFITECH.....04.01.2023
Kërkesa për rishqyrtim MONT ELEKTRO.....04.01.2023
Vendimi i AK-se ne kërkesat për rishqyrtim.....10.01.2023
Ankesat ne OSHP – Mont Elektro SHPK.....20.01.2023
Ankesat ne OSHP – Profitech SHPK.....20.01.2023

Per tenderin disa pjese te ankeses jane perseritur, dhe ne lidhje me LOTet është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP-së, me Nr.337/22 i dt: 07.10.2022

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Operatori Ekonomik "PROFITECH Shpk" ne ankesën e tij pretendon se janë shkelur dispozitat si ne vijim:

Në bazë të **Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr.05/L-092**
Eshte shkelur:

1.1.1. Kushtetutën e Kosovës,
1.1.2. Neni 3. Barabarësia para ligjit,
1.1.3. Neni 24, Barazia para ligjit,
1.1.4. Ligjit Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237 Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092
1.1.5. Neni 1 Qëllimi
1.1.6. Neni 2
1.1.7. Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi
1.1.8. Neni 4.1.36 Tenderët e pa-përgjegjshëm
1.1.9. Neni 7 – Pika 1 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi
1.1.10. Neni 24 pika 2
1.1.11. Neni 52 Njoftimi i kritereve për dhënie te kontratës
1.1.12. Neni 56
1.1.13. Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
1.1.14. Neni 60 Kriteret për dhënien e kontratës
1.1.15. Neni 64
1.1.16. Neni 66
1.1.17. Neni 67
1.1.18. Neni 69
1.1.19. Neni 71
1.1.20. Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik
1.1.21. Qëllimi i rregullave dhe udhëzuesi
1.1.22. Neni 24 par 3. Përshtatshmëri
1.1.23. Neni 26. Kriteret e përzgjedhjes

Neni 39, Sqarimi i Tenderëve i RrUOPP

Bazuar në "**Njoftimin mbi Vendimin e Autoriteti Kontraktues**" si dhe **"Letrën Standarde për Tenderuesin e Eliminuar"** të datës: **30.12.2022**, vendimi i marr ngaKomisioni Vlerësues është i pa bazuar;
Arsyetimi nga ana e AK-së për eliminim në **"Letrën standarde për tenderuesin eeliminuar"** të datës: **30.12.2022**, është i pa bazuar:
Arsyetimi nga ana e AK-së:

- [illegible] Lartësia e kokës 95 mm, mbrojtja ne Aneksi 1 te dosjes se tenderit eshtë kërkuar 94 [illegible] qe e bëhet sipas rregullit ne Vizatimin nr 5, Mungon Temperatura e operimit -200°C
- [illegible] Mungojnë karakteristika Koka e elementit Crom i nikluem zjarrdurues, mungon Diameteri [illegible] mm [illegible] dy bulona per shtërngim [illegible] = 31 mm, mungon Gjatësia e elementit L dhe Diameteri [illegible] = 6 mm
- [illegible] vërtetimin e vlefshmërisë dhe vërtetimin e ofertës

Për Poz. Nr. 5 – në **"Përshkrimin e Çmimeve"** në kolonën **"Shënim Operatori Ekonomik"** ne i kemi deklaruar specifikat teknike te produktit qe ofrojmë te cilat janë nepërputhshmëri te plotë me specifikacionin e kërkuar ne dosje te tenderit:

[illegible]	9. Termoelement [illegible]	238.00	18.00	278.48	10.00	pcs	2 360.00	2 764.80	424.80	Inol	Termoelement TT-30, 1x type K, L=2500mm, -200/+1200°C, tube DN22 x 2mm, EN1 4749, L=1000mm, klasa 2, alu head type A, flange 78mm between screws

Sa i përket arysetimit nga ana e AK-së për lartësinë e kokës, kjo nuk gjene asnjë arsyetim se ndryshimi prej 1 mm nuk mirët as për baze duke pasur parasysh se nuk ndikon ne performancën apo ne saktësinë e matjes duke e ditur se koka mbetet ne hapësirë, te bashkangjitur mund te gjeni edhe njëherë katalogun me te gjitha specifikat te cilat janëofruar.

Për temperaturën -200 °C, te gjithë sensoret e tipit K teorikisht masin temperaturën prej: -200 °C deri +1200 °C. Gjë qe e kemi cekur edhe ne **"Shënim Operatori Ekonomik"** po ashtu mund te gjeni edhe ne katalogun e prodhuesit. Këto Termoelemente porositen sipas kërkesës.

Për pozicionet Nr. 7, 8 dhe 9 po ashtu ne **"Përshkrimin e Çmimeve"** në kolonën **"Shënim Operatori Ekonomik"** i kemi deklaruar specifikat teknike te produkteve qe ofrojmë te cilat janë ne përputhshmëri te plote me specifikacionin e kërkuar ne dosje te tenderit, duke pasur parasysh se Elementet matës porositen sipas kërkesës, për këtë arsyene kemi vendosur katalogun gjeneral dhe i kemi vendosur te gjitha te dhënat teknike ne kolonën **"Shënim Operatori Ekonomik"**:

[illegible]	7. Elementa matës [illegible]	25.00	18.00	29.50	20.00	pcs	500.00	590.00	90.00	Inol	Measuring element-insert TC, 2x tip J (Fe-CuNi), L=625mm, 66mm, crom-nickel plate, head diameter ß 41mm, screw distance 33mm, SS316, acc. ISA&ANSI MC96.1
8	8. Elementa matës [illegible]	28.00	18.00	33.04	20.00	pcs	560.00	660.80	100.80	Inol	Measuring element-insert TC, 2x tip J (Fe-CuNi), L=1025mm, 66mm, crom-nickel plate, head diameter ß 41mm, screw distance 33mm SS316, acc. ISA&ANSI MC96.1
9	9. Elementa matës [illegible]	28.00	18.00	33.04	20.00	pcs	560.00	660.80	100.80	Inol	Measuring element-insert TC, 1x tip J (Fe-CuNi), L=1025mm, 66mm, crom-nickel plate, head diameter ß 41mm, screw distance 33mm SS316, acc. ISA&ANSI MC96.1

Si dëshmi te bashkangjitur mund te gjeni deklaratën dhe Specifikat Teknike nga ProdhuesiINOL ku deklaron se: i gjithë materiali i ofruar INOL do të bëhet saktësisht sipas pikave të kërkuara ne të dhënat në tender dokumentacionin.

Shkelja Neni 7 par 1. i LPP-ës
Shkelja e nenit 7 par 2. i LPP-ës,
Neni 7 par 3. i LPP-ës, përcakton
Neni 7 par 6. i LPP-ës.

Në bazë të **Neni 39, Sqarimi i Tenderëve i RrUOPP-së**, për këto pika AK është dashur tepaktën që të bënte një "Kërkesë për Sqarimin e Tenderit" e jo automatikisht të procedohet me eliminim.
Ne më datë **03.01.2023** kemi bërë kërkesë për qasje në dosje të tenderit të OE të rekomanduar për kontratë **"N.T.SH. MONT ELEKTRO"** dhe na është mundësuar qasja me datë: **04.01.2023.**

Kemi vene re se:
Per POZ 5 - Mungon ne katalog gjatësia: L prej 2500 mm
Per POZ 7, 8 , 9 mungojnë gjatësitë ne katalogun e ofruar
Po ashtu materiali i ofruar nuk është Crom i nikluem zjarrdurues siç është kërkuar ne dosjene tenderit.

Edhe pas Kërkesë për Rishqyrtim te parashtruar nga ana jonë pran AK, kërkesa jone është refuzuar si e pa bazuar me po te njëjtin arsyetim sikurse ne **"Letrën Standarde për Tenderuesin e Eliminuar"** të datës: **30.12.2022.**

Pretendimet e OE ankuese PROFITECH shpk

[illegible] LOT 1 – Poz. 5 [illegible] ne katalogjet e ofruara nga OE mungojnë disa karakteristika që janë kërkuar [illegible] ne Aneksi 1 – Specifikimet teknike të detyrueshme ne Dosje te tenderit, si: Eshte ofruar Lartesia e [illegible] 95 mm, ndërsa ne Aneksi 1 te dosjes se tenderit eshte kërkuar 94 mm [illegible] gjë qe është paraqitur [illegible] Mungon Temperatura e operimit -200 C

[illegible] OE 1 – Poz. 7, 8 dhe 9 ne katalogjet e ofruara nga OE mungojnë disa karakteristika që [illegible] Aneksi 1 – Specifikimet teknike te detyrueshme ne Dosje te tenderit, si: Mungon [illegible] Crom i nikluem zjarrdurues, mungon Diametri i kokës = 41 mm me [illegible] mm, mungon Gjatesia e elementit L dhe Diametri mbeshtqellësit = 6 mm

Gjithashtu pretendimi se OE te rekomanduar per kontrate N T SH "Mont Elektro" ne Poz. 5, 7, 8 dhe 9 te LOT 1 [illegible] mungojnë disa nga gjatësitë e elementeve ne katalogjet e ofruara, nuk qendron sepse karakteristikat kërkuara, me te nenvizuara te order codet ne katalogjet e ofruara, shih foton

[illegible] gjatësitë e elementeve te kërkuara ne Aneksi 1 – Specifikimet teknike te detyrueshme [illegible] Dosje te tenderit, si dhe njësia e elementit janë te veshura me Nikël zjarrdurues.

Ankesa e kërkesës e paraqitur për rishqyrtim nga OE "Profitech" SH P K refuzohet si e pabazuar

Për pozicionet Nr. 5, 7, 8 dhe 9 ne i kemi dhëne specifikat e detajuara ne **"Përshkrimin e Çmimeve"** në kolonën **"Shënim Operatori Ekonomik"** siç edhe e kemi elaboruar me lart.

Arsyetimi nga ana e AK-së se OE i rekomanduar për kontratë N.T.SH. "Mont Elektro" për pozicionet 5,

7, 8 dhe 9 i ka të nënvizuara gjatësitë ne katalogët e ofruar te order codetnuk qëndron;

Për pozicionin Nr. 5 ne katalogun e ofruar nga ana e OE te rekomanduar për kontrate nukështë e specifikuar gjatësia:
Si dëshmi me poshtë mund te gjeni një pjese te shkëputur nga katalogu i ofruar i OE terekomanduar për kontrate:

	(4) Nominal length NL in mm (180 ≤ NL ≤ 1400)
500	500 mm, fitting length (EL) 100 to 460 mm
710	710 mm, fitting length (EL) 100 to 670 mm
1000	1000 mm, fitting length (EL) 100 to 960 mm
1400	1400 mm, fitting length (EL) 100 to 1360 mm
..	Specification in plain text (100 mm steps)

Po ashtu edhe për pozicionet Nr. 7, 8 dhe 9 ne katalogun e ofruar nga ana e OE terekomanduar për kontrate nuk është e specifikuar gjatësia:
Si dëshmi me poshtë mund te gjeni një pjese e shkëputur nga katalogu i ofruar i OE terekomanduar për kontrate

8. ELEMENT LENGTH (EL)	XXXXX
XXXXX	50 mm up to 10.000 mm

Po ashtu ne katalogun e ofruar nga OE te rekomanduar për kontrate
Nuk është i specifikuar e as i nënvizuar materiali për pozicionet Nr. 7, 8 dhe 9 i cili është kërkuar te jete Crom i nikluem.
AK për LOT 2 tek një OE tjetër ka kërkuar edhe katalogje shtese ndërsa ne rastin tone nuke ka bere as një kërkese për sqarimin e tenderit, gjë që ka te bej me diskrimin ndaj Operatoreve Ekonomik
Vlen të cekët po ashtu se çmimi i ofruar nga ana jonë është për **5,184.92 €** më i ulët se OEi rekomanduar për kontratë:
ku AK në bazë të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës Nr. 04/L-042i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr.05/L-092

sipas: **Neni 1 Qëllimi.**
Ka për qellim: Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhemë të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.

dhe Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti,
Paragrafi 1, ku: Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësishtduke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.
Neni 104 par 1, i LPP-ës , "Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që

diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shumë operatoreve ekonomik.

14. Në bazë të LPP dispozitave, konkreisht të nenit 7 dhe 104. Referuar veprimeve nga kushtet e tenderit të dhëna nga AK, pretendimeve që kemi dhënë për shkelje si më lartë të cekura, japin shkas dhe argumente të mjaftueshme që të Aprovohet ankesa jonë që ky vendim të ndryshohet ashtu që të aprovohet ankesa e paraqitur nga opertari ekonomik

Përfundimisht ju njoftojmë që pretendimet e palës/paraqitëses së kërkesës, tani paraqitëse të kësaj ankese, kanë të bëjnë me pretendimet për shkeljet e Ligjit për Prokurimin Publik neni 1, 7, 8, 10, 27, 28, 35, 39 dhe neni 104, me këtë del në pah që ankuesi ka paraqitur një tërësi kërkesash/pakënaqësi dhe pretendime për shkeljet në procedurën paraprake e që konsiderojmë që janë të bazuara

VENDIM

APROVOHET si e bazuar ankesa e OE **"Profitech sh.p.k."**

ANULOHET Njoftim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues me datë të publikuar me **30.12.2022**, lënda të kthehet në rivlerësim dhe më pas të shpallet fitues OE **"Profitech sh.p.k."**,

Pretendimet ankimore te parashtruara ne ankesën e deponuar ne OSHP, janë/nuk janë te njëjta.

<u>Operatori Ekonomik "MONT ELEKTRO Shpk" ne ankesën e tij pretendon se janë shkelur dispozitat si ne vijim:</u>

Ne pretendojmë se AK ka shkelur këto nene të LPP-së:

1. **AK ka shkelur Nenin 7 të LPP-së,**
2. **AK ka shkelur Nenin 28 të LPP-së,**
3. **AK ka shkelur Nenin 59 të LPP-së,**
4. **AK ka shkelur Nenin 65 të LPP-së**
5. **AK ka shkelur Nenin 69 të LPP-së**

   Gjatë Rivlerësimit dhe gjatë shqyrtimit të Kërkesës për Rishqyrtim AK kashkelur nenin 56.3 të LPP-së

AK ka shkelur nenin 7 të LPP-së ku gjatë ri-vlerësimit të tenderit tonë ka aplikuar kritere që nuk i ka pasur fare të parashikuara në dosjen e tenderit sepse përmes pyetje përgjigjeve i ka larguar nga dosja e tenderit. Përpos kësaj AK gjatë shqyrtimit të Kërkesës për Rishqyrtim i ka ndryshuar arsyet e eliminimit dhe për refuzim të kërkesës tonë aplikon kritere të reja që gjithashtu nuk janë fare kërkesa të dosjes së tenderit përkatësisht nuk janë kërkesa të Aneksit 1.Aplikimi i kritereve shtesë që nuk i ka pasur në dosjen e tenderit sepse të njëjtat i ka larguar gjatë sqarimeve të dosjes së tenderit, përbën shkelje të plotë të nenit 56.3 të LPP-së dhe njëkohësisht konsiderohet diskriminim i hapur i kompanisë tonë. Pra kjo tregon mjaftueshëmse AK gjatë procesit të rivlerësimit ka bërë trajtim jo të drejtë të OE ku neve si tenderues i përgjegjshëm na ka diskriminuar me aplikim të kritereve që nuk ishin fare pjesë e dosjes së tenderit përkatësisht Aneksit 1. Kjo konsiderohet shkelje e plotë e nenit 7 të LPP-së mbi trajtimin e drejt, të barabartë dhe jo diskriminimin e ndonjë OE. Detajet e shkeljeve të tilla dhe argumentimin e të kundërtës e gjeni në pretendimet në vazhdim

AK ka shkelur nenin 28 të LPP-së – pasi që gjatë vlerësimit të tenderëve nuk ka respektuar kërkesat që vet

i ka vendosur në dosje të tenderit përkatësisht në Aneksin 1 të dosjessi dhe i ka modifikuar gjatë përgjigjes në pyetjet e ndryshme të OE. **Siç e parasheh edhe LPP çdo modifikim i kërkesave përmes pyetje/përgjigjeve duhet të respektohet gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve dhe se ligjërisht ky ndryshim bëhet edhe pjesë e kërkesave të dosjes së tenderit përkatësisht Aneksit 1 të sajë.**

Ja si duket modifikimi i specifikimit teknik që AK ka bërë tek pyetje përgjigjet:

Pyetje EO	Përgjigje e Autoritetit Kontraktues:
Pyetja njësoj 21 Per LOT 5, Kutia Kompensuese [illegible] per rrjetin [illegible] Actuator [illegible] [illegible] Nr. 13 [illegible] "Kutia furnizuese [illegible] sepse nuk është e qartë [illegible] "Kutia furnizuese" Nese kerkohet vetem actuator [illegible] ne vazhdim Nr. 13 [illegible] sepse nuk [illegible] Actuator Prodhues [illegible] furnizim elektrik 230V/10-60 VDC por ne kontraktes e marrim ate pjese te furnizimit per furnizim 230V/10-60 VDC dhe [illegible]	**Nuk kërkohet furnizimi elektrike, e kemi nga pajisjet e vjetra.**

Sipas kësaj shihet se tek pozicioni 13 nuk kërkohet kutia furnizuese por kërkohet vetëm acuatori sepse kutinë furnizuese AK thekson se e posedon nga pajisje të vjetra. Ja si ishte fillimisht kërkesa nga AK tek pozicioni 13.

13	**Kutia furnizuese me actuator per furnizim te Valvave** Karakteristikat teknike Materiali: Aluminium (Poxhdi [illegible]) ; Klasa mbrojtese IP 65 sec. ; ki DIN 40050 Tensioni: 230 V/110/50 Hz/Hz ; Temperatura ambientit -25°C ; +70°C Gjeneratori Qarkut: 200 mA ; Per shkak te inkorporimit shif VZ.Nr.13.	copë	5

Ja si dukej edhe vizatimi i paraqitur nga AK:



Poz. 13.

Sipas kësaj shihet se pjesa e sipërme mbi acuator është kutia furnizuese për të cilën AK ka theksuar se nuk ka nevojë të furnizohet fare sepse e posedojnë nga pajisje të ngjashme të vjetra. Si arsye e eliminimit tonë si konkurrent i papërgjegjshëm si dhe si arsye e refuzimit të kërkesës tonë për rishqyrtim si të pabazuar është

përdorur pikërisht pozicioni 13 dhe pjesa e pajisjes të cilën AK e ka larguar nga kërkesa me rastin e përgjigjeve në pyetjen e OE.

Sipas kësaj del që aplikimi i specifikimeve teknike të kësaj pjese të pozicionit 13 është aplikuar gabimisht dhe në kundërshtim me nenin 28 të LPP-së sepse kjo pajisje nuk ishte kërkuar fare. Edhe po të ishte kërkuar, prapë arsyetimet për mos plotësim të specifikimeve teknike janë të pabazuara sepse kutia furnizuese që ne e kemi ofruar i plotëson të gjitha kriteretdhe kërkesat e kutisë së kërkuar në fillimi nga AK e që më pas ishte larguar nga kërkesa/aneksi

1. Detajet teknike të aplikimit të gabuar të arsyeve për eliminim dhe refuzim të kërkesës për rishqyrtim nga ana e AK-së i gjeni në pretendimin e radhës mbi shkeljen e nenin 59 të LPP-së. Veprimi i AK-së duke mos respektuar specifikimet teknike të Aneksit 1 si dhe modifikimet e bëra përmes pyetje/përgjigjeve bie në kundërshtim të plotë edhe me praktikat e mira të prokurimit të përcaktuara tek neni **20** i **RRUOPP-së** që bazohet plotësisht në nenin 28 të LPP- së, e i cili ndër të tjera thotë

*Specifikimet teknike janë të kërkesa të **obligueshme**, te cilat të gjithë tenderët duhet te respektojnë me mënyrë që të jenë të **përgjegjshëm.***

Nisur nga kjo konstatohet se AK ka shkelur nenin 28 të LPP-së e si rrjedhojë e kësaj ka ardhur edhe te shkelja e nenit 20 të RRUOPP-së pasi që nuk i ka respektuar kërkesat e parashtruara nëdosjen e tenderit nga vetë AK-ja

3. AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së pasi që gjatë vlerësimit nuk i ka respektuar kërkesat e veta përkatësisht ka aplikuar gabimisht kërkesat e dosjes së tenderit ashtu siç ishin përcaktuar paraprakisht si dhe siç i kishte modifikuar përmes pyetje/përgjigjeve. Neni 59.4 i LPP-së shumë qartë e përcakton se

Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderinë fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

E themi këtë sepse AK na ka eliminuar pa të drejtë nga konkurrenca duke aplikuar një kriter qëvet e kishte larguar përmes pyetje përgjigjeve para datës së tenderimit. Arsyeja e eliminimit tonë tek Lot 3, pas rivlerësimit të tenderëve duket kështu.

[illegible] 250 VDC dhe [illegible] bazuar
[illegible] Kërkuar Tensioni: 220V/ 10-60 VDC dhe Constant Current 200
[illegible] -25ºC, ndërsa është ofruar -20ºC, Dimensionet e ofruara
[illegible] vërtetë kërkohëra në sitatim

Fillimisht duam të sqarojmë se kjo pjesë e pajisjes që AK e ka kontestuar në aspektin e specifikimit teknik ishte larguar nga nevoja për ofertim dhe liferim me datën 26.04.2022 përmes përgjigjes në pyetjen e një OE të interesuar. Ja si duket kjo përgjigje e AK dhe largim i pjesës së furnizimit me energji elektrikë të pozicionit 13

Pyetje EO	Përgjigje e Autoritetit Kontraktues:
[illegible]	Nuk kërkohet furnizimi elektrike, e kemi nga pajisjet e vjetra.

Sipas kësaj del që specifikimet teknike të përcaktuara tek pozicioni 13 largohen nga kërkesa dhe mbetet për ofertim dhe liferim vetëm ACUATORI që ndodhet nën kutin e furnizimit me energji elektrike. Bazuar në këtë dhe në faktin që tek pozicioni 13 ishin të përcaktuara vetëm specifikimet teknike të kutisë së furnizimit me energji elektrike, del që aplikimi i tyre është i pabazuar pasi që kjo pjesë nuk ka pasur të ofertohet dhe liferohet fare. Ja si duken specifikimetteknike të përcaktuara tek pozicioni 13 e që AK i kishte larguar me përgjigjen e tyre të datës 26.04.2022.

13	Kutia furnizuese me actuatori per furnizim te Valvave [illegible] [illegible] IP 65 acc. to DIN 40050 [illegible] 220 [illegible] VDC [illegible] ambientit -25°C ... +70°C [illegible] 10 mA [illegible] shif viz fir 13	copë	8

Pra krejt këto specifika janë aplikuar në rivlerësim të tenderit tonë sepse në fakt kjo pajisje ishte larguar nga aneksi 1 me përgjigjen e AK që i ka kthyer OE. Pra aplikimi i këtij kriteri është në kundërshtim të plotë me nenin 56.3 të LPP-së i cili e thotë qartë se:

> Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla ne baza te ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është i cekur ne njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Ky aplikim i kërkesave të tilla të aneksit 1 është bërë në kundërshtim të plotë me dosjen tenderit dhe me përgjigjen e AK ku si pasojë konstatohet se AK ka shkelur tërësisht nenin 59të LPP-së.

Pavarësisht asaj që AK e ka larguar si kërkesë kutinë furnizuese me energji elektrike duke e lënë tek pozicioni 13 vetëm ACUATORIN si kërkesë për ofertim dh eliferim, ne në ofertën tonë kemi ofertuar vetëm me çmimin për ACUATORIT por tek katalogu e kemi prezantuar atësë bashku me kutinë furnizuese. Këtë pjesë AK nuk është i detyruar ta merr por nëse dëshiron ta mbaj atëherë ne ofrojmë pa pasur nevojë të paguaj për të.

Edhe sikur të kishte mbetur tek kërkesat e aneksit 1 kutia furnizuese, nuk qëndron arsyetimi iAK-së se gjoja kjo kutí nuk i plotëson karakteristikat teknike të përcaktuara nga AK(*që në fakti kishte larguar).* E themi këtë sepse kutia e prezantuar në katalogun tonë (*edhe pse nuk ishtekërkuar*) i plotëson kriteret që AK në fillim i kishte vendosur tek Aneksi 1. Ja përse:

Karakteristikat e kutisë furnizuese të paraqitur nga ne në katalogun tonë janë: tensioni U= 250VDC dhe rryma I=5A që janë karakteristika shumë më të mira se ato të kërkuara në specifikimteknik nga AK*(ë larguara më pas me përgjigjet në pyetjet e OE*) pasi pajisja e tillë e durontensionin U= 250 VDC pa asnjë problem si dhe i përballon edhe tensionet me te vogla siç janëkërkuar fillimisht tek Aneksi 1- Lot 3 pozicioni 13. **U=250 V/10-60VDC** .

Sa i përket vlerës së rrymës së kërkuar tek Aneksi 1 - Poz.13 e që është 200mA (0.2A), atë e përballon shumë më mirë pajisja e ofruar nga ne sepse e ka kontaktorin që e përballon rrymën deri në 5A. Pra ne kemi ofruar pajisje me specifikime me te mira për 25 herë!

Sa i përket vërejtjes tuaj për temperature ku gjoja pajisja e jonë (*kutia furnizuese -e cila gjate pyetjeve sqaruese*

shtë larguar nga AK) nuk është e rezistueshme në temperature -25°C, mendojmë se ky konstatim i juaji nuk qëndron pasi që në katalogun e prodhuesit e keni shumë qartë të sqaruar se si pajisje standarde prodhohet për temperaturat -20 °C deri +70 °C, por me kërkesë speciale të blerësit mund të prodhohet me dizajn special "Special design on request". Shihe si e paraqet prodhuesi në katalog

Temperature range	Standard -20°C to +70°C Special design on request

Edhe sa i përket vërejtjes tuaj për dimensionet e kutisë furnizuese mendojmë se edhe kjo pikë eeliminimit nuk qëndron sepse pajisja (*kutia furnizuese*) e ofruar nga ne në katalog është me dimensione me të vogla se ato të kërkuara në dosjen e tenderit që tregon se është me praktike(*montohet me lehte*) se sa ajo që ishte fillimisht në specifikim teknik ku sipas interpretimit të KRPP-së "çdo pajisje që posedon performancë më të mira se ato të kërkuara në dosje të tenderit dhe që nuk krijon kosto shtesë për AK, duhet pranuar". Kjo pajisje figuron në katalog por çmimin e kemi ofruar vetëm për ACUATORIN kështu që këtë pajisje nuk e ka të nevojshme me detyrim me marrë AK-ja. Nëse e donë mund ta mbaj pa ndonjë kompozim shtesë për të por nëse jo, ne e kthejmë mbrapsht. Pavarësisht krejt kësaj, kjo pajisje nuk është kërkuar të ofertohet sepse AK përmes pyetje përgjigjeve e ka larguar si kërkesë andaj edhe aplikimi si arsyetim për refuzim të tenderit tonë për diçka që nuk kërkohet konsiderohet shkelje e plotë e nenit 56.3 dhe 59 të LPP-së.

Pas parashtrimit të Kërkesës tonë për Rishqyrtim, AK e ka parë gabimin e vet andaj në përgjigje ndaj kërkesës tonë tashmë e ka ndryshuar qasjen dhe arsyetimin lidhur me konsiderimin e tenderin tonë si të papërgjegjshëm. AK tash ka aplikuar dimensionet e kutisë për furnizime elektrike të cilën e ka larguar nga specifikimi teknik para hapjes publike si dimensione të ACUATORIT dhe që gjoja nuk e plotësojnë kriterin e kërkuar tek Aneksi 1. Jasi duket arsyeja e refuzimit të Kërkesës për Rishqyrtim.

[illegible] N.P.SH. "Mont Elektro"

[illegible] actuator per furnizim te Valvave

[illegible] dimensione te kutise furnizuese,edhe kjo pike e

[illegible] ofruar nga ne eshte me dimensione me te vogla se

[illegible] me praktike (me lehte montohet) se ajo qe

[illegible] Pshkurtsia e kutise furnizuese e kerkuar me

[illegible] kutise furnizuese te ofruar nga

[illegible] kute furnizuese nuk e perfshinin

[illegible] ofruar shkon kutia perkatese.



Tek pozicioni 13 i Lot-it 3 AK kishte vendosur vetëm të dhëna dhe dimensione për kutinë e furnizimit elektrik ndërsa për ACUATORIN nuk kishte vendosur as edhe një të dhënë të vetme. Dimensionet që AK i përdor nuk janë dimensione të ACUATORIT por janë dimensione të Kutisë furnizuese me energji elektrike, kuti e cila ishte larguar nga specifikimi teknik i Aneksit 1 me datë 16.04.2022.

Shihe se duke' në fillim ky specifikim teknik:



Poz. 13.

Sipas këtij arsyetimi shihet se AK pretendon se në dosjen etenderit paska kërkuar dimensione të ACUATORIT dhe atë si në vijim: **L=160mm** dhe **H=55mm**

Tek vizatimi teknik i pozicionit 13 të Lot-it 3 janë dhënë vetëm dimensionet e kutisë furnizuese elektrike dhe

dimensionet e pllakës lidhëse të kutisë furnizuese me ACUATORIN. Dimensionet e ACUATORIT nuk janë kërkuar fare andaj si duket Komisioni Vlerësues paska pasur nevojë për një Inxhinier Profesionist që din të lexoj dimensionet nga vizatimi teknik. Ja sqarimi ku tregohet se dimensionet e tilla i takojnë kutisë furnizuese që AK e kishte eliminuar nga kërkesat e Aneksit , e jo ACUATORIT.



Poz. 13.

Fra nga ky sqarim po shihet se dimensionet e tilla janë të kutisë furnizuese dhe sipas kësaj po del që aplikimi i tyre si dimensione të ACUATORIT është plotësisht veprim jo profesional dhei kundërligjshëm. Krejt këto sqarime i bëmë vetëm sa për të ju sqaruar se AK ka aplikuar gabimisht dimensione të pesës që e ka eliminuar nga Specifikimi Teknik përmes përgjigjeve sqaruese andaj me plot të drejt e themi se AK ka shkelur nenin 56.3 dhe nenin 59 të LPP-së merastin e eliminimit tonë si tenderues të papërgjegjshëm. Kriteret e aplikuara AK i ka eliminuar nga kërkesat e dosjes së tenderit andaj tenderi jonë konsiderojmë se është plotësisht i përgjegjshëm dhe i plotëson të gjitha karakteristikat teknike të përcaktuara nga AK.
Bazuar në krejt këtë që theksuam më lartë konstatohet se AK ka shkelur plotësisht nenin 59 të LPP-së me rastin e eliminimit të tenderit tonë si tender i papërgjegjshëm tek Lot 3 i këtij tenderi. Dëshmitë e përdorura nga ne i gjeni të bashkangjitura

4. AK ka shkelur nenin 65 të LPP-së sepse si pasojë e mos vlerësimit real të ofertave sipaskërkesave të dosjes së tenderit, asaj që kërkon neni 7, neni 28, dhe neni 59 i LPP-së, jetë shkelur apo mos respektuar edhe neni 65 i LPP-së. Arsyeja pse mendojmë se është shkelur ky nen është se Anëtarët e Komisionit para vlerësimit e nënshkruajn një deklaratë në përputhje me këtë nen të cilës nuk i janë përmbajtur fare. Mos vlerësimi në përputhje me kriteret e dosje së tenderit dhe aplikimi i kritereve shtesë që nuk i kishte në dosjen e tenderit e shtynë AK-së drejt shkeljes së nenit 65 të LPP-së. Veprimin e njëjtë e ka bërë edhe AK me rastin e vlerësimit të tenderit dhe pranimit të informatave të tilla si të mirëqena

5.AK ka shkelur **nenin 69 të LPP-së** sepse nuk ka respektuar kërkesat e nenit në fjalë, sidomos pikat 69.2.4. dhe 69.2.5 të këtij neni pasi që nuk i ka vlerësuar si duhet artikujt eofruar ne. Në këtë nen shumë qartë tregohet se për rastet e tilla të procedurave të furnizimit OEduhet të ofrojnë dokumente autentike të prodhuesit me përshkrim të karakteristikave teknike saktë ashtu siç i ka kërkuar edhe AK në dosje të tenderit. Me vetë faktin që në dokumentin autentik të prodhuesit dhe në ato që kemi ofertuar ne tregohet se karakteristikat teknike të artikujve e sidomos të atij tek pozicioni 13 – Lot 2 janë në përputhje me kërkesat e Aneks 1, del që AK nuk i ka respektuar kërkesat e vendosura në përputhje me këtë nen andaj me plot kuptim konstatojmë se AK ka shkelur nenin 69 të LPP-së me rastin e vlerësimit dhe krahasimittë tenderëve.

Pas gjithë këtyre sqarimeve dhe fakteve të ofruara, shpresojmë dhe besojmë që OSHP do ta shqyrtoj me kujdes ankesën tonë kundër vendimit të AK-së dhe njëherit do ta aprovoj si të bazuar. Nisur nga kjo, kërkojmë nga OSHP që pas shqyrtimit të ankesës dhe verifikimit të fakteve si dhe argumenteve të ofruara nga ne por edhe atyre që i posedon në lëndën e kësaj procedure, të merr:

V E N D I M

APROVOHET e bazuar ankesa e OE **"NTSH MONT ELEKTRO"** lidhur me tenderin **"Furnizimi me pjesë për MRRK në TCA – LOT 3"**, i iniciuar nga **Korporata Energjetike e Kosovës SH.A..**

ANULOHET njoftimi mbi vendimin e AK- **Korporata Energjetike e Kosovës SH.A.** dhe lënda të kthehet në ri-vlerësim.

Ri-vlerësimi të bëhet plotësisht dhe vetëm duke u bazuar në dispozitat ligjore të LPP-së, kërkesat e dosjes së tenderit përkatësisht në specifikimet teknike të **Aneksit 1** dhe ato të modifikuara përmes pyetje/përgjigjeve, e që realisht më pas do duhej që **FITUES** të shpallej OE **"NTSH MONT ELEKTRO"**.

Pretendimet ankimore te parashtruara ne ankesën e deponuar ne OSHP, janë/nuk janë te njëjta.

KRITERET PËR VLERËSIM

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe ose profesionale	9.1 & 9.2	**Kapaciteti teknik dhe professional** 1.Certifikatë të produkteve,në lidhje me përshtatjen dhe specifikat ose standardet 2 Katalogë apo prezantime grafike (vizatimet)dhe osefotografi të produkteve,për furnizim.bashkangjitur përshkrimit teknikedetale,për rtikujt qe ofertoni	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* 1.**Çertifikata** (Certifikimi i prodhuesit sipas ISO 9001:2015) **(Vlen për secilin lot të tenderit)** . **2.Dokumentacioni autentik i prodhuesit si: katalogë/pjese te katalogut nga prodhuesi dhe/ose vizatimet autentike** të vërtetuara nga prodhuesi me përshkrim teknike detale për artikujt qe ofertoni.Ne katalog/pjese te katalogut dhe/ose vizatim sipas specifikimeve teknike te kërkuara te nënvizohen artikujt për pozicionet e kërkuara.**(Vlen për secilin lot të tenderit)** .

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:

LOT 1 :
1.Dynamic Electro SH.P.K.- I PAPERGJEGJSHEM
NUK E KA VAZHDUA VALIDITETIN E OFERTES DHE SIGURIMIT TE TENDERIT
2.N.T.SH. " MONT ELEKTRO "- I PERGJEGJSHEM
3.Power Engineering SH.P.K.- I PA PERGJEGJSHEM
Poz. 1 Mungon karakteristika Mbrojtja: IP 66/67, NEMA4X
Poz. 3 Mungon katalogu
Poz. 4 Mungon karakteristika Furnizimi: 14.....35 VDC, mungon mbrojtja: IP 68, mungon Materiali: F16 housting
Poz. 5 Është ofruar Lartësia e kokës: 95 mm, ndërsa në Aneksi 1 të dosjes së tenderit është kërkuar 94 mm , gjë që është paraqitur në Vizatimin nr.5
Mungon karakteristika Temperatura e operimit: -200?
Poz. 6 Mungon katalogu
Poz. 7 Mungon karakteristika Koka e elementit: Crom i nikluem zjarrdurues, mungon Diametri i kokës: ? = 41 mm, me dy bulona për shternim ? = 31 mm, mungon Gjatësia e elementit L dhe Diametri i mbështjellësit ? = 6 mm
Profitech- I PA PERGJEGJSHEM
POZ 5 Është ofruar Lartësia e kokës: 95 mm, ndërsa në Aneksi 1 të dosjes së tenderit është kërkuar 94 mm , gjë që është paraqitur në Vizatimin nr.5, Mungon Temperatura e operimit: -200?C
POZ 7 Mungon karakteristika Koka e elementit: Crom i nikluem zjarrdurues, mungon Diametri i kokës: ? = 41 mm, me dy bulona për shternim ? = 31 mm, mungon Gjatësia e elementit L dhe Diametri i mbështjellësit ? = 6 mm
4.UNION L.L.C I PAPERGJEGJSHEM
NUK E KA VAZHDUA VALIDITETIN E OFERTES DHE SIGURIMIN E TENDERIT

LOT 3
1.Power Engineering SH.P.K- I PA PERGJEGJSHEM
POZ 11 MUNGON KATALOGU ME PERSHKRIM TEKNIK
POZ 12 MUNGON KATALOGU ME PERSHKRIM TEKNIK
POZ 13 nUK JANE OFRUAR DIMENSIONET E KERKUARA NE VIZATIM

2.N.T.SH. " MONT ELEKTRO "- I PA PERGJEGJSHEM
POZ 13 Është ofruar karakteristika U=250 VDC dhe I=5A (bazuar në foton e katalogut të ofruar), ndërsa është kërkuar Tensioni 220V/10-60 VDC dhe Constant Current 200 mA, Temperatura e ambientit është kërkuar:
-25?C, ndërsa është ofruar: -20?C, Dimensionet e ofruara nuk përkojnë me dimensionet e kërkuara në vizatim.
3." Profitech " SH.P.K.- I PAPPERGJEGJSEHM
POZ 5-Mungon karakteristika Shkalla për tregim: 110%, Mungon Temperatura e ambientit: -20?C,...+60?C
Është kërkuar Shtypja: 25 bar, ndërsa është ofruar 6 bar
POZ 13-Është ofruar karakteristika Tensioni 230 V, por jo edhe tensioni 10-60 VDC,është ofruar karakteristika Current 3A, ndërsa është kërkuar Constant Current 200 mA, Temperatura e ambientit është kërkuar:
-25?C..+70?C , ndërsa është ofruar:
-20?C..+70?C . Dimensionet e ofruara nuk përkojnë me dimensionet e kërkuara në vizatim.

4.Dynamic Electro SH.P.K- I PA PAERGJEGJSHEM
NUK E KA VAZHDUA VALIDITETIN E OFERTES DHE SIGURIMIN E TENDERIT

Komisioni i vlerësimit deklaron se aktiviteti i prokurimit është udhëhequr duke respektuar dispozitat e LPP-së Nr 04/L-042 Ligji për Prokurimin Publik në Kosovë, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr 05/L-092, Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik dhe rekomandon qe oferta e OE N.T.SH. " MONT ELEKTRO ", Hyzri Talla 2/5, 10000, Prishtine te shpërblehet me kontrate për LOT 1

Komisioni i rivlerësimit pas ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit te tenderëve për aktivitetin e Prokurimit KEKO-22-227-121- Furnizimi me pjesë për MRRK në TCA
Lot.3 Rregullator te temperaturës, Termometra bymetal, Rregullator i presionit dhe shkarkues i kondenzatit . Senzor i shtypjes 0-1 bar, dhe Kutia furnizuese me actuator për furnizim te Valvave, konstaton se nga 4 (katër) ofertat qe kanë mbërri ne ZEP, te gjitha ofertat janë te pa përgjegjshme.

Komisioni i rivlerësimit ne mungese te ofertave te përgjegjshme propozon qe ky LOT te anulohet.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA E EKSPERTËVE SHQYRTUES DHE / OSE TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

Operatoret Ekonomik janë pjesë e procedurës se prokurimit prandaj vlerësohet se është palë me interes sipas nenit 4.1.26).

VENDIMET E MËPARSHME TË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

(Të sqarohet nese për rastin e njejtë është dhënë vlerësim tjetër).

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES "PROFITECH SHPK DHE MONT-ELEKTRO SHPK" - PRISHTINË

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES "PROFITECH SHPK

Përgjigje në Pretendimi nr.1

Lidhur me pretendimin e OE ankues qe ka te beje me ofertën e tij saktësisht me pozicionin nr 5 te aneksit 1 te dosjes se tenderit specifikimi teknik eksperti shqyrtues sqaron se AK ne vlerësimin e ofertës se OE te rekomanduar për kontrate sa i përket pjesës se "**NL Nominal Length**' Operatori Ekonomik i rekomanduar per kontrate ka ofruar në katalogun e tij si më poshtë.

	(4) Nominal length NL in mm (180 ≤ NL ≤ 1400)
500	500 mm, fitting length (EL) 100 to 460 mm
710	710 mm, fitting length (EL) 100 to 670 mm
1000	1000 mm, fitting length (EL) 100 to 960 mm
1400	1400 mm, fitting length (EL) 100 to 1360 mm

AK kishte kërkuar që Nominal length (gjatesia nominale) të jete 2500 mm të cilën katalogu i OE të rekomanduar për kontratë nuk e plotëson. Përkundër faktit se komisioni i vlerësimit ju ka referuar "order codit" i njëjti nuk e saktëson gjatësinë e produktit sikur ne pozicionet e katalogut 7, 8 dhe 9.

Operatori Ekonomik ankues poashtu në të njëjtin pozicion të lartësia e kokës ka ofruar kokën për 1 mm më të vogël se ne vizatimin e AK-së por në faqen e dytë të katalogut ka ofruar edhe disa tipe tjera të kokave.
Eksperti shqyrtues konstaton se perkunder faktit se OE ankues kishte dhënë pershkrim të produktit të ofruar AK-ja kishte kërkuar "**Dokumentacioni autentik i prodhuesit si: katalogë/pjese te katalogut nga prodhuesi dhe/ose vizatimet autentike** të vërtetuara nga prodhuesi me përshkrim teknike detale për artikujt qe ofertoni" dhe se përshkrimi i dhënë nuk është në perputhje me kërkesat e specifikimit teknik.

Eksperti shqyrtues vlerëson se AK gjatë vlerësimit dhe krahasimit të ofertave të dy OE nuk ka përdorur standarde te njëjta. Ne bazë te Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
Autoriteti kontraktues do te konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me te gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse:
ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit te tenderëve

Prandaj ne bazë të dokumenteve të ofertës, dosjes së tenderit, specifikimit teknik, AK duhet qe vleresimin dhe krahasimin e ofertave ta bëjë në përputhje me nenin 59 te LPP-se dhe ti trajtojë të gjithë OE në menyrë të barabartë.

Përfundim:
Eksperti shqyrtues pas analizimit te pretendimit te Operatorit Ekonomik ankues vlerëson se pretendimi është pjeserisht i bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr.2

Lidhur me pretendimin ankimor qe ka te beje me pozicionet 7, 8 dhe 9 te specifikimit teknik eksperti shqyrtues konstaton se Operatori Ekonomik ankues ne listën e çmimeve te **"Shënim Operatori Ekonomik"** bashkangjitur edhe ne pretendimin ankimor me larte OE ankues ka dorëzuar listën e çmimeve ku përfshihen te gjitha karakteristikat e produktit.
AK-ja ne kërkesën e dosjes se tenderit kishte kërkuar "2.Katalogë apo prezantime grafike (vizatimet) **dhe ose** fotografi të produkteve, për furnizim, bashkangjitur përshkrimit teknike detale, për artikujt qe ofertoni
2.**Dokumentacioni autentik i prodhuesit si: katalogë/pjese te katalogut nga prodhuesi dhe/ose vizatimet autentike** të vërtetuara

nga prodhuesi me përshkrim teknike detale për artikujt qe ofertoni.Ne katalog/pjese te katalogut dhe/ose vizatim sipas specifikimeve teknike te kërkuara te nënvizohen artikujt për pozicionet e kërkuara.**(Vlen për secilin lot të tenderit)** .

Sikurse në pretendimin e parë eksperti shqyrtues konstaton se përkunder faktit se OE ankues kishte dhënë përshkrim të produktit të ofruar AK-ja kishte kërkuar "**Dokumentacioni autentik i prodhuesit si: katalogë/pjese te katalogut nga prodhuesi dhe/ose vizatimet autentike** të vërtetuara nga prodhuesi me përshkrim teknike detale për artikujt qe ofertoni" dhe se përshkrimi i dhënë në atë menyrë nuk është në perputhje me kerkesat e specifikimit teknik.

Sa i përket pjesës ku OE ankues i referohet katalogut te OE te rekomanduar për kontrate eksperti shqyrtues konstaton se katalogu i OE te rekomanduar për kontrate i përmban te gjitha kërkesat qe kane te bëjnë me gatësinë e produkteve por nuk e plotëson kërkesën qe ka te beje me "Koka e elementit Crom i nikluem zjarrdurues"

- Mineral insulated
- Spring loaded design
- Ceramic block with Ni-plated or Silver plated terminals



Në të gjitha përshkrimet ne katalog OE i rekomanduar për kontratë i referohet produktit me material **"nickel plated"** derisa në kërkesë është **"crom i nikluem zjarrdurues".** Prandaj eksperti shqyrtues vlerëson se AK-ja duhet të veprojë në përputhje me nenin 38.1 dhe 45.19 te RRPP 001/2022 kur bënë vlerësimin dhe krahasimin e ofertave.

Përfundim:
Eksperti shqyrtues pas analizimit te pretendimit te Operatorit Ekonomik ankues vlerëson se pretendimi është pjesërisht i bazuar.

Perfundimisht eksperti shqyrtues konstaton se OE ankues si edhe OE i rekomanduar per kontrata nuk i plotesojne kerkesat e dosjes se tenderit Aneks 1 dhe rrjedhimisht nuk jane te pergjegjshem per kete aktivitet te prokurimit.

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES "MONT ELEKTRO" SHPK

Përgjigje në Pretendimi nr.1

Sqarim: Meqenëse ankesa i është referuar pozicionit 13 te specifikimit teknik te dosjes se tenderit OE ankues eksperti konstaton se pretendimin do ta trajtojmë si një pretendim te vetëm.

Lidhur me pretendimin e OE ankues sa i përket pjesës ku kontestohet furnizimi me "kutinë furnizuese" AK-ja dhe OE ankues në përgjigjen e kërkesës për sqarim te datës 26.04.2022 nuk ka qene e çartë se çka është menduar me "nuk kërkohet **furnizimi elektrike**", "**e kemi nga pajisjet e vjetra**". Për me tepër e njëjta nuk është trajtuar qartë nga AK-ja me rastin e kërkesës për rishqyrtim të OE ankues dhe rrjedhimisht nuk i është dhënë

përgjigje e duhur.

Sa i perket pjesës ku OE ankues i referohet: temperatures rezistente, tensionit dhe rrymes eksperti shqyrtues konstaton se AK-ja në përgjigjen e saj me daten 10.01.2023 ne kërkesën për rishqyrtim nuk i ka vendosur si arsye të eliminimit këto pretendime rrjedhimisht konsideroj se është pajtuar me to dhe nuk do të shqyrtohen në këtë ekspertizë

Ne lidhje me pretendimin e OE ankues i cili në vazhdimësi i është referuar kutis furnizuese eksperti shqyrtues konstaton se dosja e tenderit e publikuar me daten 26.04.2023 ne ankesin 1 te specifikimit tenik ka te perfshirë edhe **kutia furnizuese me actuator per furnizim te Valvave – shih foton**



Perkundër faktit se AK-ja nuk ka dhënë një pergjigje të qartë në kërkesën për sqarim të datës 26.04.2023 eksperti shqyrtues konstaton se meqenëse AK-ja çdo ndryshim apo korrigjim te dosjes se tenderit do të duhej ta bënte me anë të formularit B54 për korrigjimin e gabimeve derisa ne sistemin e eprokurimit nuk ka të publikuar një të tillë për këtë procedurë të prokurimit prandaj konsiderojmë se kutia furnizuese nuk ishte eliminuar nga kërkesa e dosjes së tenderit.

Sa i përket pjesës së ankesës se OE në lidhje me dimensionet e Aktuatorit eksperti shqyrtues konstaton se vizatimi i AK-s e ka mangesi ne përshkrim të vizatimit por që në këtë fazë konsiderojmë se nuk do të ndryshojë rezultatin duke pas parasysh se dimensionet e kutisë furnizuese nuk përputhen me kerkesat e Aneksit 1 te dosjës së tenderit.
Prandaj konsiderojmë se sipas nenit 19.11 te RRPP OE ankues nuk e ka plotesuar kërkesen e specifikimit teknik.

> 19.11 Specifikimet teknike janë kërkesa obligative, të cilat të gjithë tenderët duhet t'i përmbushin në mënyrë që të konsiderohen tenderë të përgjegjshëm.

<u>Përfundim:</u>
<u>Eksperti shqyrtues pas analizimit te pretendimit te Operatorit Ekonomik ankues vlerëson se pretendimi është i pa bazuar.</u>

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e **OE PROFITECH Shpk** të aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe njekohësisht rekomandoj që të **anulohet aktiviteti** i prokurimit duke pas parasysh se OE të mbetur në këtë procedurë janë vlerësuar si të papërgjegjshëm.

Ndërsa sa i perket ankesës së **OE MONT ELEKTRO Shpk** duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa të refuzohet si **e pa bazuar** dhe te mbetet ne fuqi njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a..**
- Panelit Shqyrtues – OSHP.
- OE ankues - **MONT ELEKTRO Shpk, PROFITECH Shpk.**